



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.C.nr.1037/18

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Bujar Muzaqi kryetar, Mehmet Ndrecaj dhe Burim Shala anëtarë, në çështjen juridike të paditësit M.K. nga Fshati ..., Komuna Lipjan të cilin e përfaqëson J.B., avokat me seli në Komuna Lipjan, kundër të paditues Kompania e Sigurimeve “S...” me seli në Komuna Prishtinë, në çështjen kontestimore për kompensim të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të paditësit, dhe të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.40/2015 datë 04.12.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 28.08.2020, mori këtë :

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e themeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...” me seli në Komuna Prishtinë, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.40/2015 datë 04.12.2017, dhe gjykohet si vijon : **PJESËRISHT APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit M.K. nga Fshati ..., Komuna Lipjan si e bazuar, **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “S...” me seli në Komuna Prishtinë t’i paguaj paditësit M.K. nga Fshati ..., Komuna Lipjan në emër të dëmit jo material : në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 3.500,00 € (tremijëepesqindëuro), për shkak të frikës së përjetuar shumë prej 2.000,00 € (dy mijë €uro), në emër të shëmtimit trupor shumë prej 2.500,00 € (dymijëepesqindëuro), për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 7,000.00€ (shtatëmijë €uro), ndërsa pjesa tjetër përtej shumë së gjykuar, **REFUZOHET** si e pa bazuar.

II. REFUZOHEN si të pa themelta ankesat e paditësit dhe të paditurës, sa i përket vendosjes në pjesën tjetër të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – dega në Lipjan, departamenti i përgjithshëm, C.nr.40/15 datë 04.12.2017, dhe i njëjti, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.62/16 datë 06.09.2016, ndër të tjera ka vendosur si vijon “... I. **PJESËRISHT APROVOHET** kërkespadiapadia e paditësit M.K. nga fshati ..., si e **BAZUAR, OBLIGOHET** pala e paditur Kompania e Sigurimeve “S...” me seli në Prishtinë, që paditësit tja paguaj në emër të shpërblimit të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit rrugor dt.21.06.2014, në rrugën magjistrale Prishtinë - Ferizaj tek udhëkryqi Gllgovc – ... dhe atë: në emër të dhimbjeve fizike shumë të mëdha totale prej 7,500.00 €, - në emër të frikës së përjetuar shumen prej 4.000.00€, në emër të dhimbjeve shpirtërore për shëmtim shumë prej 5.800,00 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë të mëdha totale prej 8.500,00 €, për ndihmë dhe kujdes të huaj shumë prej 294 €, për ushqim të përforcuar shumë prej 420, e të gjitha me kamatë vjetore prej 8%, duke filluar nga 04.12.2017 e gjer në pagesën definitive nga të cilat shuma të aprovuara i zbritet shuma prej 2.000,00 € të cilën e paditura ja ka dhënë paditësit në emër të paradhënjes, II. Në pjesën tjetër kërkespadiapia e paditësit, më tepër se shumatat e aprovuara, si në al. I pika 1 dhe 2 të dispozitivit të këtij aktgjykimi, si dhe kërkespadiapia për terapi fizikale dhe rehabilitim në shumë prej 900,00 €, **REFUZOHEN** si të pa bazuara. III.**OBLIGOHET** e paditura, që paditësit tja paguaj në emër të shpenzimeve kontestimore shumë prej 1.807.20 €...”.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i paditësit, për shkak të zbatimit të vërtetimit të gabuar jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar të Gjykatës ose ta kthejë në rigjykim.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë edhe i autorizuari i të paditurës, për shkak të shkëlqjeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe gjeti se:

- **Ankesa e të paditurës është pjesërisht e themeltë.**
- **Ankesa e paditësit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi me datë 09.02.2015, përmes të autorizuarit të saj, ka paraqitur padi ndaj të paditues, me kërkesë për kompensimin e dëmit.

Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 04.12.2017, dhe pas dëgjimit të palëve ndërgjyqëse, dëgjimit të ekspertëve mjekësor, marrjes së mendimit nga eksperti i komunikacionit, dhe pas administrimit të provave, si dhe provat e tjera që gjenden në shkresa të lëndës, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, duke e aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, e në pajtim me nenin 179, 183 të LMD-së, për kamatë vendosi bazuar në nenin 382.2 të LMD-së, për lartësi vendosi bazuar në nenin 323 të LPK-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës e mori në pajtim me nenin 452.1,5 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ndër të tjera ka arsyetuar se : *“...Lartësin e dëmit të pësuar jo material paditësve gjykata ua ka caktuar sipas qmuarjes të lirë, konform nenit 323 të LPK-së, nenit 179, n. 183 të LMD-së, dhe duke u mbështetur në konstatimin dhe mendimin e ekspertëve gjyqësor, përkitazi me natyrën dhe shkallen e lëndimeve të pësuar nga paditësit, intensitetin dhe kohëzgjatjen, kriteret e kompanive të sigurimit per caktimin e lartesis se dëmshpërblimit, praktikes gjyqësore te gjykatave ne Kosove...”*.

Vlerësimet juridike të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullta dhe të bazuara në ligj pjesërisht i aprovon edhe kjo gjykatë, sepse aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar gjendjen faktike sa i përket pjesës së ndryshuar dhe vërtetuar sipas këtij aktgjykimi, e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore dhe kështu e kishte një pasqyrë reale mbi gjendjen në këtë çështje kontestimore.

Mirëpo për kundër vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, gjykata e shkallës e parë gabimisht e ka aplikuar të drejtën materiale, përkitazi me aspektet e dëmit jomaterial, për paditësin M.K. për dhimbjet e pësuar, për frikën e përjetuar, për shëmtim, dhe për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe vlerësimin të lartësisë së aprovuar, duke aprovuar shuma të larta të cilat nuk janë në përputhje me qëllimin e kompensimit të dëmit, andaj Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes vlerëson se paditësit i takon e drejta në kompensim të dëmit, duke u bazuar në dispozitat, nenit 136,169, 173, 183 dhe nenit 961 të LMD-së, si dhe bazuar në nenin 323 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, vendosja si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është bërë duke marrë

parasysh të gjitha rrethanat, vuajtjet e pësuara dhe natyrën e lëndimeve të paditësit, ku shumat e gjykuara në emër të shpërblimit të dëmit jo-material, si shpërblim i drejtë dhe se shumat e aprovuara paraqesin një formë të satisfakcionit që paditësi me këto mjete të i plotësojë nevojat, dhe të mirat materiale të dëmtuara nga pasojat e aksidentit të komunikacionit.

Gjykata e Apelit duke marrë parasysh të gjitha provat e administruara në këtë çështje juridike dhe atë ekspertizën e komunikacionit të punuar nga eksperti Yll Koshi, ka vërtetuar gjendjen faktike, se aksidenti i komunikacionit ku paditësi kanë pësuar dëmtime trupore ka ardhur si pasojë e lëshimeve primare të drejtuesit të automjetit i cili ka drejtuar automjetin me targa të regjistrimit të shtetit ..., nga kjo rrjedhë edhe e drejta e paditësit dhe detyrimi i të paditurës për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga aksidenti, po ashtu sa i përket bazës juridike edhe i autorizuari i të paditurës në seancën e mbajtur në Gjykatë me datë 04.12.2017 ndër të tjera ka deklaruar se *“...pales se demtuar i ofrojme shumen prej 7.000,00 €, duke konsideruar se eshte satisfaksion real per kete rast tek demet jo material duke ja zbrit kesaj shume edhe shumen prej 2.000,00 €...”*.

Gjykata e Apelit duke e marrë parasysh lëndimet e pësuara të paditësit, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se shuma e kompensimit të dëmit të gjykuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë sa i përket kompensimit në emër të dëmit jo material për dhimbjet e pësuara, për frikën e përjetuar, për shëmtim, dhe për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor është e lartë andaj edhe e ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar, duke gjykuar që paditësit M.K., nga Fshati ..., Komuna Lipjan t'ia njoh në emër të dëmit jo material : në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 3.500,00 €, për shkak të frikës së përjetuar shumë prej 2.000,00 € (dy mijë €), në emër të shëmtimit trupor shumë prej 2.500,00 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 7.000,00€ (shtatë mijë €), duke u bazuar edhe në mendimin dhe konstatimit e ekspertëve mjekësor V.B., ortopede dhe Dr.V.S., psikiatër të cilët dhënë mendim se në bazë të dokumentacionit mjekësor, M.K. ka pësuar lëndime të rënda trupore, dhe ka pasur dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë që ka zgjatur 40 minuta, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm 12 javëve, dhe ka pasë dhimbje te intenzitetit te ulet në kohëzgjatje prej 6 muajve, ka pësuar frikë të intenzitetit të lartë afër 24 orë, frikë sekundare e intenzitetit të mesëm deri në tri javë, dhe frikë sekundare e intenzitetit të ulët deri në 3 muaj, dhe të njëjtat ekspertiza janë punuar në mënyrë profesionale dhe të argumentuar, që përndryshe do të vinte në dyshim validitetin e saj, të cilës Gjykata me të drejtë ia fali besimin e plotë dhe vendosi konform saj, duke marrë parasysh se lëndimet e pësuara të paditësit janë të natyrës së rëndë trupore, shuma e gjykuar në emër të kompensimit të dëmit jo material, dhe material është në përpjesëtim dhe në harmoni me natyrën e lëndimeve të marra.

Sa i përket shumës së aprovuar në shumë prej 7.000,00 € në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, dhe shuma prej 2.500,00 € për shëmtim për paditësin M.K., gjykata u bazua edhe në mendimin e Dr. V.B., ortopede e cila në mendimin e dhënë me datë 03.11.2017 ndër të tjera ka deklaruar se “...Zvogëlimin e përgjithshëm ka ne shkalle prej 12.5%...”, ndërsa “... shëmtim trupor, ka te shkalles së ulët...” i cili ekspert është dëgjuar në seancën e mbajtur në gjykatë me datë 03.11.2017, ndërsa palët ndërgjyqëse nuk kanë kërkuar ndonjë ekspertizë tjetër mjeksore.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar si reale shumën sa i përket vendosjes së kompensimit të paditësit për ushqimin e përforcuar, ku edhe e ka vërtetuar aktgjykimin e atakuar, pasi në bazë të mendimit të ekspertëve mjekësor, të cilët kanë vlerësuar se paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar, në kohëzgjatje prej 60 ditësh, dhe ndihmë nga personi i tretë në kohëzgjatje prej 6 javësh, andaj këtë pjesë edhe e ka vërtetuar, si reale dhe të drejtë.

Gjykata e Apelit ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e vërtetuar pjesën për shpenzimet e procedurës, duke aprovuar dhe obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës, t’ia paguajë paditësit shumën prej 1.807.20€, dhe të njëjtat i ka arsyetuar, Gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë lidhur me shpenzimet e procedurës duke u bazuar në nenin 452 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, duke i arsyetuar të njëjtat.

Sa i përket pretendimit ankimor të paditësit, lidhur me kërkesën për shërim klimateriko – banjor, ky pretendim është i pa bazuar, pasi pala paditëse nuk ka ofruar ndonjë provë me të cilën do ta bënte të besueshme se realisht i është nënshtruar terapisë e cila sipas ekspertëve mjekësor ka qenë e nevojshme, në kohëzgjatje prej dy jave vite, edhe sipas raporteve mjekësore është rekomanduar ky trajtim por mungojnë provat se paditësi i është nënshtruar trajtimit dhe shpenzimet janë krijuar, në mënyrë që të i njihet ky lloj kompensimit i dëmit.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të palëve ndërgjyqëse, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimin e atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195.1 pika d) dhe e), e lidhur me nenin 200 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
A.C.nr.1037/2018 datë 28.08.2020

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Bujar Muzaqi